



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

RELACION MBI BUXHETIN E VITIT 2019

Është nder por edhe përgjegjësi e madhe për Ministrinë e Kulturës që vjen në prezantimin e buxhetit të Qeverisë për Kulturën për vitin 2019.

Natyrisht që të prezantosh e të mbrosh buxhetin e gjashtë në menaxhim të politikave kulturore, do të thotë që tashmë një rrugë e gjatë është bërë në ndërtimin e sistemit të administrimit të sektorit publik të kulturës dhe analiza nuk bëhet më me “se si e gjetëm” por “sa kemi ecur”, dhe ku duam të mbërrijmë.

Ndonëse nuk duhet harruar se në çfarë derexheje ishte ky sektor në vitin 2013.

Tashmë standardet e punës e të projekteve janë vendosur dhe sfidën e kemi me veten tonë për të qenë në lartësinë e organizatës ku duam të integrohemi por edhe të pritshmërive të publikut që, me të drejtë, ecin më shpejt se sa punët tona.

Në mandatin tonë të parë ne treguam se arritëm ta nxjerrim Kulturën nga gropa e borxheve dhe gjendja e emergjencës duke e kthyer **kulturën në prioritet** dhe motor zhvillimi e pasaportë kombëtare.

Por edhe në vitin e parë të këtij mandati treguam shumë qarte stabilitetin në prioritetet tona.

Gjatë viteve 2013-2018 u synua dhe u arrit të konsolidohej, përmirësohej struktura muzeale si dhe të hapeshin 4 objekte të reja me karakter muzeal. Pavarësisht fondeve të limituara të buxhetit të Ministrisë së Kulturës, u arrit të ngriheshin fonde me partnerët strategjikë disafish më të larta sesa periudha 2005-2013 dedikuar trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale. Rigjallërimi i institucioneve të artit dhe kulturës përgjatë këtyre viteve, zgjoi interesin e njerëzve ndaj aktiviteve kulturore.

Gjithashtu në sajë të angazhimit të veçantë janë ngritur fonde dhe planifikuar projekte e investime konkrete në të gjitha rajonet e Shqipërisë për Ministrinë e Kulturës, nëpërmjet koordinimit të disa sektorëve strategjikë të qeverisjes qendrore dhe partnerëve, Veçojmë këtu bashkëpunimin tepër të frytshëm me Fondin Amerikano-Shqiptar të Zhvillimit, Delegacionin Evropian në Shqipëri, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Bankën Botërore, PNUD-in etj.

Si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm kërkesat buxhetore sipas zërave të projekt buxhetit të vitit 2019, krahasuar me buxhetin e vitit 2018 paraqiten si më poshtë:

Buxheti MK 2019

Në lekë

N/R	Emertimi Llogarive	2018	2019	%
nr.1	Paga + sigurime shoqerore (600+601)	937,500,000	961,000,000	103%
nr.2	Shpenzime Korrente (602-606)	396,237,000	443,026,000	112%
nr.3	Shpenzime nga te ardhurat (602/5)	26,160,000	56,841,000	217%
nr.4	Investime (230+231)	650,000,000	705,000,000	108%
	Shuma	2,009,897,000	2,165,867,000	108%

Nisur nga treguesit e mësipërm, projektbuxheti i vitit 2019 krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2018 ka një rritje prej 156 milion lekë, nga të cilat **55 milion lekë në investime** dhe, **në korente 101 milion lekë**, ku për t'u theksuar është rritja e shpenzimeve nga të ardhurat (602/5) prej 31 milion lekë si rezultat i rritjes së të ardhurave këtë vit, si dhe plotësimi i nevojave për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Per tu theksuar është se kjo rritje në të ardhurat do të shkojë e gjitha në mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Duke e sjelle kështu punën me pasuritë kulturore në thelbin e restaurimit që është **MIREMBAJTJA!**

Nese monumentet e kultures mirembahen rregullisht ato s'kane nevojë për ndërhyrje të thella.

Nese sot e kësaj dite vijojme me restaurime të thella e të rëndësishme, kjo ndodh sepse prej dekadash s'ka pasur mirëmbajtje dhe rrenimi zuri rrenje.

Më poshtë po paraqesim projekt buxhetin e vitit 2019 të krahasuar me buxhetin e vitit 2018, sipas programeve buxhetore të Ministrisë së Kulturës.

Emertimi	Buxheti			%
	2018	2019	diferenca	
Planifikim, Manaxhim	160,276,000	160,276,000	-	100%
Trashëgimi Kulturore dhe Muzete	635,072,000	522,191,000	(112,881,000)	82%
Art & Kulture	1,214,549,000	1,483,400,000	268,851,000	122%
Shuma	2,009,897,000	2,165,867,000	155,970,000	108%

Rritje më e madhe është në programin e Art&Kulturë për arsye se investimet kanë kaluar të gjitha në këtë program pasi siç dhe kemi kërkuar në shtojcën e PBA 19-21 Faza II do të prokurojmë pajisjet e TOB-it të cilat kapin një shifër prej 430 milion lekë.

-PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PAGA E SIGURIME SHOQËRORE (600+601)

Paga dhe sigurimet shoqërore këtë vit janë plotësuar në masën 100 % ndryshe nga viti kaluar. Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë do ta përballojnë të gjithë volumnin e punës me të njëjtin numër punonjësish dhe fond page. Rritja që del në tabelën e mëposhtme vjen për arsye se në 2018 tavanet nuk mbulonin nevojat sipas strukturave të miratuara (gjë e cila u plotësua gjatë vitit 2018).

Emertimi	Buxheti per Paga dhe Sigurime			%
	2018	2019	diferenca	
Planifikim,Manaxhim	115,276,000	115,276,000	-	100%
Trashegimi Kulturere dhe Muzete	280,624,000	298,924,000	18,300,000	107%
Art & Kulture	541,600,000	546,800,000	5,200,000	101%
Shuma	937,500,000	961,000,000	23,500,000	103%

-PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE KORRENTE (602 - 606)

Fondi i planifikuar për shpenzimet korrente për vitin 2019 është planifikuar të përdoret si më poshtë :

- TRASHËGIMIA KULTURORE :

Trashëgimia Kulturore, është një potencial i jashtëzakonshëm, ende i pashfrytëzuar plotësisht. Kthimi i saj në destinacion gjithëvjeter turistik dhe nxitës për një zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, kërkon ruajtjen dhe rehabilitimin e vlerave të saj. Kombinimi i programit të Rilindjes Urbane me atë të restaurimit dhe rijetëzimit të Qendrave Historike është një model suksesi.

Qëllimi ynë është të vazhdojmë ende në këto ritme nëpërmjet PBA-së 2019-2021 me restaurimet dhe rijetëzimin e qendrave të tjera historike dhe monumenteve të kulturës që kanë një potencial të vlerësuar për turizmin kulturor.


Procesi i mirëmbajtjes për konservimin e trashëgimisë kulture, është procesi më i rëndësishëm i ndërhyrjeve që garanton ruajtjen e vlerave dhe autenticitetin e tyre. Gjatë 2018 janë kryer punime mirëmbajtje në 170 monumente kulture, si banesa, objekte kulti, kala etj.

Për këtë arsye prioritet për shpenzimet korrente do të përqendrohen te mirëmbajtja e monumenteve të kulturës sipas listës së emergjencës të gjendjes fizike të tyre.

Investimi dhe përkujdesja si dhe promovimi, që kemi treguar në Trashëgiminë kulturore ka dhënë rezultate shumë të mira!

Vizitueshmëria në institucione dhe qendra të trashëgimisë kulturore Janar – Shtator 2018

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë 9- mujorit (janar – shtator) 2018 janë vizituar nga **864,711** vizitorë vendas dhe të huaj, nga të cilët **253,659 në** muzetë kombëtarë, **340,819** në parqet arkeologjike dhe **270,233 në** monumente të kulturës.



Analiza krahasuese e të dhënave statistikore për periudhën Janar-Shtator 2017 dhe 2018 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje. Periudha janar – shtator 2018 shënon **305,562 vizitorë në total më shumë** se e njëjta periudhë e vitit 2017 dhe **391,722 vizitorë në total më shumë** se e njëjta periudhë e vitit 2016.

Trendi i vizitueshmërisë (vizitorë në total) në periudhën janar – shtator në vitet 2014-2018 (në %)


Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017, vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **55%**.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **83%**.



Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **111%**.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej **165%**.


Grafiku si më poshtë.



Trendi i rritjes progresive vihet re edhe në kategorinë e vizitorëve me biletë dhe të ardhurat e gjeneruara nga institucionet. Grafikët më poshtë.



Trendi i vizitueshmërisë për periudhën janar – shtator 2014 - 2018 sipas kategorive të institucioneve dhe qendrave të vizituara është sipas grafikëve më poshtë



Rritja e numrit të vizitorëve ka bërë dhe rritjen e të ardhurave nga biletat të cilat mund të përdoren në mirëmbajtjen e Monumenteve të Kulturës, Parqet Arkeologjike dhe Muzete Kombëtarë si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to.

PROMOVIMI I VLERAVE TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE, MATERIALE DHE DIVERSITETIT KULTUROR PËRMES ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE TË PËRVITSHME.

Aktivite dhe veprimtari kulturore

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të trashëgimisë kulturore kanë organizuar një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës.

Pjesëmarrja e Shqipërisë me një pavijon të dedikuar në edicionin e 16 të ekspozitës ndërkombëtare të Arkitekturës “Freespace”, Venecia, Itali i cili u inaugurua më datë 25 maj 2018 në Arsenale di Venezia, në prani të personaliteteve dhe vizitorëve të shumtë shqiptarë dhe të huaj. Ky është prezantimi i pestë i Shqipërisë në ekspozitën ndërkombëtare të Bienales të Venecias që nga viti 2014. Ky aktivite shumë i rëndësishëm për përfaqësimin e vlerave të arkitekturës së Shqipërisë dhe promovimin e tyre dhe të identitetit kombëtar është mështetur nga Ministria e Kulturës.

Pavijoni shqiptar në këtë Bienale i përfaqësuar me projektin “**Hapësira zero**” realizuar nga ekipi kuratorial “**TiranaZeroSpace**” është një kontribut ndaj qytetit të Tiranës, i cili përfshin qytetarët e Tiranës në një pjesëmarrje aktive në Bienalen e Venecias. Pavijoni shqiptar është një moment reflektimi mbi mënyrën e jetesës dhe të ardhmen e qytetit të Tiranës.

Konferenca “**Shqipëria 60 vjet në UNESCO**” në kuadër të përvjetorit të 60-të të anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO.

ETJ

Vlera të trashëgimisë arkitektonike të mirëmbajtura gjatë vitit 2018

Procesi i mirëmbajtjes për konservimin e trashëgimisë kulture, është procesi më i rëndësishëm i ndërhyrjeve që garanton ruajtjen e vlerave dhe autenticitetin e tyre.

Gjatë 2018 janë kryer punime mirëmbajtje në 170 monumente kulture nga të cilat: 33 banesa, 44 objekte kulti dhe 93 monumente në qendrat historike.

Për këtë arsye duke patur në prioritet të punës ruajtjen e vlerave të **trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit** dhe autenticitetin e tyre të ardhurat e siguruara nga shërbimet e institucioneve gjatë viti 2018 në një vlerë të përgjithshme prej 42,500,000 lekë (26% më shumë se të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2017) përdoren për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës sipas listës së emergjencës të gjendjes fizike të tyre. Në vitin 2019, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare do të marrin një fond më të lartë për ndërhyrjet e mirëmbajtjen, në krahasim me vitin 2018.

- **ARTI DHE KULTURA:**

Në vizionin e Qeverisë dhe prioriteteve institucionale të Ministrisë së Kulturës, kultura nuk është vetëm një plotësim shpirtëror, por një domosdoshmëri për edukimin e brezit të ri, për formimin e qytetarit evropian të së nesërme, me vizion të hapur dhe gjithëpërfshirës, e njëkohësisht kultura e kuptuar si motor zhvillimi për ekonominë e vendit, si mbështetëse kryesore e sektorit të turizmit përmes ngritjes dhe zhvillimit të sipërmarrjeve kulturore në të gjithë vendin. Investimet kulturore do të kenë prioritet në rikualifikim dhe rikonceptim të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Kulturës, që synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup-moshave të ndryshme.

Programi Kombëtar “Edukimi përmes Kulturës” do të jetë vijimi i një reforme të thellë dhe të qëndrueshme në institucionet e artit dhe politikat kulturore duke vënë theksin në rëndësinë dhe rolin e edukimit përmes kulturës në kohezionin social, i provuar tashmë dhe në vende të tjera. Edukimi masiv me art e kulturë do të synojë ndërhyrjen në kurrikulat shkollore nga njëra anë si dhe përfshirjen nga ana tjetër, në çdo institucion arti të linjën pedagogjike dhe edukative.

Po ashtu, këto shpenzime korrente do të shërbejnë edhe në mbështetjen e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e trashëgimisë kulturore, artit dhe kulturës, librit, përkthimit,

krijimtarisë së re në dramaturgji dhe muzikë etj. E njëjta qasje ndaj mbështetjes së aktiviteteve kulturore do të jetë edhe për institucionet e vartësisë së këtij programi buxhetor.

Prioritet do të jetë finalizimi i projekteve për rehabilitimin e MHK dhe të GKA

Si dhe përfundimi i fazës së 2 dhe e 3 të TOB.

-Programi i Planifikimit Menaxhimit :

Me fondet e planifikuara do të sigurojë mbështetjen e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave dhe politikave të ministrisë.

- SHPENZIME NGA TE ARDHURAT (602/5)

Te ardhurat nga vizitorët janë rritur nga viti në vit dhe në krahasim me vitin 2013 këtë vit janë rritur 3 herë (duhet theksur se të ardhurat për vitin 2018 janë për periudhën Janar-Shtator).

Ne leke

Emertimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Trashegimi Kulturore dhe Muzete	52,493,730	77,515,830	97,660,998	118,342,210	141,500,700	190,096,380
Art & Kulture	9,348,750	18,956,550	18,595,610	22,086,900	15,126,770	16,250,550
Shuma	61,842,480	96,472,380	116,256,608	140,429,110	156,627,470	206,346,930

Këto tabela prezantojnë dukshëm rritjen e konsiderueshme të këtyre të ardhurave, si rezultat i politikave të ndjekura nga Ministria e Kulturës, në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj vizitorit; përmirësimit të infrastrukturës muzeore; transparencës së përdorimit të këtij shërbimi etj. Një prej hapave më të rëndësishme dhe të suksesshëm në realizimin e këtij objekti është dhe përdorimi teknologjisë së biletarisë elektronike në sitet e trashëgimisë kulturore (një prej projekteve ambicioze të Ministrisë së Kulturës, i cili do të vijojë të shtrihet në të gjithë sistemin e saj).

Si rezultat i bashkëpunimit të mirë me Ministrinë e Financave për vitin 2019 buxheti për përdorimin e të ardhurave është dyfishuar në krahasim me vitin 2018.

- SHPENZIME PER PROJEKTE KULTURORE (604)

Me vizion të qartë për të konsoliduar Skenën e pavarur të kulturës, institucioni ynë ka bashkëpunuar me subjektet e artit për të siguruar gjithëpërfshirje në jetën social kulturore duke arritur në këto shifra për periudhën janar-shtator 2018:

900 produksione kulturore si: shfaqje teatrale, koncerte, panairë, festivale, ekspozita etj

70 premiera

370 mijë spektatorë

17 mijë vizitorë në ekspozitat e zhvilluara nga Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Marubi, Muzeu Historik dhe Skena e Pavarur

200 aktivitete ndërkombëtare të realizuara në Shqipëri

32 aktivitete të realizuara në skenën Ndërkombëtare

Për herë të parë gjatë këtij viti u hartua kalendari i turizmit kulturor, një bashkëpunim i institucioneve të varësisë dhe projekteve me thirrje.

80 aktivitete në kuadër të turizmit kulturor – NJE SUKSES qe tejkaloj parashikimet tona.

1.5 shfaqje për çdo ditë të sezonit turistik (240 ditë gjithsej)

80 mijë spektatorë ndoqën balet, festival, shfaqje filmi, shfaqje muzikore etj;

16 mijë vizitorë ndoqën ekspozitat e ndryshme të insitucioneve tona dhe të skenës së pavarur

1800 artistë të angazhuar dhe rreth 150 të punësuar gjatë sezonit turistik.

23 festivale; 42 shfaqje baleti/filmi/muzikore/etj; 5 ekspozita; 8 aktivitete kulturore

Prioritet edhe për vitin e ardhshëm do të kenë projektet me thirrje të hapur, me të cilat është krijuar një traditë e mirë në këto pesë vite, në mbështetje të shoqatave të pavarura dhe artistëve. Viti 2019 rezervon angazhime, nisma dhe prioritete të reja nga ana përmbajtjesore për Ministrinë e Kulturës, ku vlen për tu përmendur aktiviteti i Bienales së Artit në Venecia, (Përfaqësimi në Panairin e Librit në Lajpcig; Kalendari i Përbashkët Kulturor

Shqipëri-Kosovë dhe Shqipëri-Maqedoni, Kalendari Kulturor i vijës Bregdetare dhe destinacioneve të tjera në shërbim të turizmit kulturor; vënien në skenë të dy veprave të mëdha skenike fituese në opera dhe balet të konkursit mbarëkombëtar të krijimtarisë muzike; Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore”; Lëvizjes Kombëtare për Leximin me shtrirje gjatë gjithë vitit; projekte afatgjate për Diasporën në fushën e letërsisë, muzikës, arteve në përgjithësi, fondi i përkthimit nga shqip në gjuhë të huaj dhe anasjelltas apo dhe shumë aktivitete, përfaqësime në evenimente ndërkombëtare dhe konkurse, të cilat për vetë rëndësinë që kanë kërkojnë angazhime të mëdha me fonde financiare. Siç dhe vërehet nga tabela e mëposhtme fondi për projektet kulturore nuk ka ndryshime me vitin e kaluar.

FONDI PROJEKTEVE KULTURORE (604)

Në lekë

Emertimi	Buxheti			%
	Viti 2018	Viti 2019	diferenca	
Trashegimi Kulturore dhe Muzete	27,524,000	32,756,000	5,232,000	119%
Art & Kulture	137,332,000	137,332,000	-	100%
Shuma	164,856,000	170,088,000	5,232,000	103%

- SHPENZIME KAPITALE TË TRUPËZUARA

Gjatë vitit 2018 një rëndësi të veçantë iu dha investimeve publike, ku për tu theksuar janë ndërtimi me sukses i qendrës kulturore ``Skena e Re`` me vlerë 465 milion lekë, si dhe avancimi i punimeve për rikonstrukcionin e Teatrit Operas dhe Baletit (Investim me vlerë totale 1,1 miliard lekë) punime të cilat kanë avancuar me ritme të larta (nga ku eshte realizuar deri ne tetor 2018 vlera prej 336.4 milion lekë). Gjithashtu jemi në përfundim të projekteve për rikonstrukcion e dy objekteve të rëndësishme si Muzeu Historik Kombëtar me vlerë totale 40 milion lekë dhe Galeria Kombëtare e Arteve me vlerë totale 15 milion lekë.

Gjithashtu është ndërhyrë në fushën e trashëgimisë në disa objekte të rëndësishme siç janë:

Restaurimi i Banesës së Vëllezërve Frashëri dhe Restaurimi i Muzeut të Sinës – Dibër. Restaurimi i këtyre dy objekteve bëri të mundur shmangjen e degradimit të mëtejshëm të tyre, kthimin e vlerave për trashëgiminë tonë kulturore si dhe futjen e këtyre objekteve në itineraret turistike të zonës por dhe më gjerë.

Restaurim Kisha e Shën Mërisë në Ristoz, Korçë, Faza e III-të, vazhdon restaurimi i kishës, i cili ka filluar në vitin 2014 - 2015. Restaurimi bëri të mundur heqjen e një monumenti mjaft të rëndësishëm nga lista e riskut të lartë.

Restaurim Kisha e Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme - Gjirokastrë, me fondin 24,600,000 janë kryer ndërhyrje restauruese në mure, kupolë, çati, restaurim dhe konservim i pikturave, si dhe restaurim i të gjithë elementeve arkitektonikë në brendësi të Kishës.

Restaurim Kisha e “Shën Apostujve” Hoshtevë, Zagori, me fondin 9,199,330 lekë. Vlerësimi dhe mirëmbajtja e kësaj trashëgimie, ndihmon në rritjen e vlerave dhe njohjen më tej të kulturës së kësaj zone. Në këtë këndvështrim, restaurimi i Kishës së Hoshtevës, do të ndihmojë në njohjen e kulturës dhe traditës së ndërtimitarisë së zonës dhe të periudhës të cilës ajo i përket.

Restaurim i kishës së Shën Nikollit (Vend varrimi Skënderbeut) – Lezhë. Restaurimi i këtij monumenti përbën interes të veçantë historik, arkeologjik e kulturor.

Restaurim "Kisha e Shën Thanasit"- Leshnicë-Sarandë. Ndërhyrjet në proces konsistojnë në konservimin dhe konsolidimin e pjesës së mbetur të Kishës pas tërmetit në vitin 2017.

Restaurim Kisha Manastirit të Shën Mërisë Mesopotam Faza I -Sarandë, ka bërë të mundur ruajtjen dhe konsolidimin e skemës egzistuese statike, funksionale dhe tipologjike të këtij objekti me vlera për trashëgiminë tonë kulturore dhe arkitektonike.

Restaurimi i Objektit Ura e Kollorcës 4 km në juglindje të Gjirokastrës, Lazarat 4,980,000 lekë. Me anë të kësaj ndërhyrje, është siguruar qëndrueshmëria e urës dhe jep mundësinë e restaurimit të plotë të saj në të ardhmen. Është miratuar vetëm faza e shpëtimit, faza emergjente.

Restaurim Ura Nivanit, Nivan-Ndëran, Zagori, Gjirokastrë, Ura e Golikut ne Moker, Ura e Katiut ne Benje te Permetit

Kisha e Shen Merise ne Benje te Permetit

Kisha e Shen Merise ne Kosine

2 Kisha ne Libofshe (Shen Meria dhe Shen Kolli)

5 xhami Berat, Gjirokaster, Tirane, Rusan Delvine.

Tabela e mëposhtme tregon ritjen e investimeve në vitin 2019.

Emertimi	Buxheti			%
	Viti 2018	Viti 2019	diferenca	
Planifikim, Manaxhim	-	-	-	0%
Trashegimi Kulturore dhe Muzete	200,000,000	5,000,000	(195,000,000)	3%
Art & Kulture	450,000,000	700,000,000	250,000,000	156%
Shuma	650,000,000	705,000,000	55,000,000	108%